

V E N D I M

Nr.743, datë 27.11. 1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.235, DATË 15.5.1995 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË RRUGËVE”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 15.5.1995, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Këshilli Kombëtar i Rrugëve” drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe përbëhet nga:

- | | |
|---|---------|
| -Ministri i Punëve Publike dhe të Transportit | anëtar |
| -Ministri i Pushtetit Lokal | anëtar |
| -Ministri i Tregtisë dhe i Bashkëpunimit Ekonomik | anëtar |
| -Zëvendësministri i Financave | anëtar |
| -Zëvendësministri i Rendit Publik | anëtar |
| -Drejtori i Drejtorisë së Rrugëve | anëtar |
| -Pesë specialistë | anëtarë |

Specialistët caktohen nga Kryetari i Këshillit të Rrugëve, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike e të Transportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Majko

Pandeli